



SYLLABUSI I LËNDËS “PROGRAMIMI”

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike		
Titulli i lëndës:	Programimi		
Programi:	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi		
Niveli:	Baçelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	1		
Numri i orëve në javë:	2+2 (ligjërata dhe ushtrime)		
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS		
Koha / lokacioni:	Të publikuara në web site të universitetit!		
Mësimdhënësit e lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Ercan Canhasi Ass. Arta Misini, Ph. D. c.		
Të dhënat kontaktuese:	ercan.canhasi@uni-prizren.com arta.misini@uni-prizren.com		
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs përfshin konceptet bazë të programimit si variablat, aritmetikën dhe shprehjet; deklaratimet e kushtëzuara; iterimin; funksionet statike; vargjet dhe matricat.		
Qëllimi i lëndës:	Kjo është lënda e parë e programimit në shkencën kompjuterike. Lënda përqendrohet në analizën e problemit dhe zhvillimin e algoritmeve dhe programeve kompjuterike në gjuhë të nivelit të lartë - Java. Studentët do të fitojnë njohuri në konceptin e programimit kompjuterik, duke shfrytëzuar gjuhën programuese Java si mjet kryesor të zhvillimit.		
Rezultatet e të nxënit:	Në fund të kursit, studentët duhet: <ul style="list-style-type: none">• Të analizojnë dhe zgjidhin problemin;• Të përdorin gjuhën programuese Java, për të zgjidhur problemin;• Të lexojnë dhe “debagojnë” programin në Java• Të mësojnë sintaksën e gjuhës programuese Java.		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	1	1	1
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	6	30



Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj	4	2	8
Totali			150 orë (6 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda është kombinim i ligjëratave, diskutimeve, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, ndërsa detyrat prezantohen nga mësimdhënësi në laborator.		
Metodologjia e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vijueshmëria në ligjërata dhe ushtrime: 5% + 5% • Detyrat: 10% • Testi i parë: 40% • Testi i dytë: 40% • Ose provimi përfundimtar: 100% 		
Literatura			
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ercan Canhasi, Arta Misini (2019). Hyrje në Programim - Programimi në JAVA. 2. P.Deitel and H.Deitel. (2012). Java: How to Program (9th edition). Prentice Hall. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ivor Horton. Beginning Java 2, JDK (5th edition). 2. Bruce Heckel. Thinking in Java (5th edition). 		

Plani i dizajnuar i mësim:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Gjuhën programuese Java	Hyrje
<i>Java e dytë:</i>	Si të shkruhet, kompilohet dhe ekzekutohet (interpretohet) kodi në Java	Shkruarja, kompajlimi dhe ekzekutimi (interpretimi) i kodit në Java
<i>Java e tretë:</i>	Struktura e programit Ndryshoret (variablat) dhe konstantet Tipet e të dhënave	Struktura e programit Variablat dhe konstantet Tipet e të dhënave
<i>Java e katërt:</i>	Shënimi i rezultatit (output) në konsolë Komentet në Java Shprehjet	Shënimi i rezultatit (output) në konsolë Komentet në Java Shprehjet
<i>Java e pestë:</i>	Operatorët dhe Prioritetet Operatori i përcaktimit	Operatorët dhe Prioritetet
<i>Java e gjashtë:</i>	Konvertimi i të dhënave	Konvertimi i të dhënave
<i>Java e shtatë:</i>	Kontrolli i rrjedhës / Deklaratat e kushtëzuara Deklarata if - else Bllok deklaratat	Degëzimet (if-else, operatori ternar)
<i>Java e tetë:</i>	Testi i parë	Ushtrime për testin e parë
<i>Java e nëntë:</i>	Deklaratat if të ndërlidhura Deklarata switch	Deklaratat if të ndërlidhura Deklarata switch
<i>Java e dhjetë:</i>	Deklaratat përsëritëse while ciklet do/while ciklet	Ciklet (while, do-while)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Deklaratat përsëritëse for ciklet	Ciklet (for)



<i>Java e dybëdhjetë:</i>	Funksionet statike	Funksionet statike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Vargjet	Vargjet
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Matricat	Matricat
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi i dytë	Ushtrime për testin e dytë
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<ul style="list-style-type: none">• Në përgjithësi prezantimet e ligjëratave do të bëhen përmes MS PowerPoint, tabelës, përdorimit të materialeve, programeve kompjuterike dhe ushtrimeve numerike.• Po ashtu, nga mësimdhënësit do të sigurohen edhe materiale tjera shtesë (punime shkencore, publikime, buletinet nacionale, si dhe zbulimet dhe hulumtimet e fundit).• Në mungesë të mundësisë që puna praktike të organizohet çdo javë, në bashkëpunim me menaxhmentin e universitetit, ky aktivitet do të organizohet në ditë të caktuara në: organizata, kompani, njësitë prodhuese-përpunuese, etj.• Gjatë çdo seancë do të organizohet qasja e bashkëbisedimit dhe bashkëparticipimit me studentë!• Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjëratat dhe ushtrime!• Do të vlerësohet kontributi i studentëve kur ata bashkëpunojnë dhe participojnë në ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës!• Ardhja e studentëve me kohë në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme!		